



Në bazë të nenit 52 paragrafi 52.2 dhe nenit 12.2 pika d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 26 paragrafi 26.2 dhe nenit 13 paragrafi 13.1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e shtatë të rregullt, e mbajtur më datën 29.07.2024, merr këtë:

V E N D I M Nr. 37/2024/KG

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT GJASHTËMUJOR FINANCIAR TË DREJTORISË SË BUXHETIT DHE FINANCEVE PËR VITIN 2024

Neni 1

Miratohet Raporti gjashtëmuor financiar i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për vitin 2024.

Neni 2

Raporti i miratuar gjashtëmuor financiar për vitin 2024 është paraqitur në tabelën dhe tekstin e mëposhtëm:

Nr.r	Kategoria ekonomike	Vlera e buxhetit	Alokimi për 6 muaj	Shpenzimet për 6 muaj	% të shumës së buxhetit	% të alokuara	% të alokimit të buxhetit
1.	Paga dhe medijtje	4,284,719.83	2,016,031.69	2,000,203.64	46.68	99.21	30.27
2.	Mallra dhe sherbime	1,998,803.85	1,895,099.85	1,029,674.10	51.51	54.33	28.46
3.	Sherbime komunale	299,713.13	289,713.13	125,999.81	42.04	43.49	4.35
4.	Subvencion e dhe transfere	591,395.41	584,563.73	142,500.00	24.10	24.38	8.78
5.	Shpenzime kapitale	2,910,712.97	1,866,387.01	758,447.80	26.06	40.64	28.03

6.	Donacione	7,285.16	7,285.16	0.00	0.00	0.00	0.11
7.	Rezerva	0.00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
8.	Total	10,092,630.35	6,659,080.57	4,056,825.35	40.20	60.92	100.00

Nga tabela e paraqitur shihet se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e dytë të vitit 2024 është 10,092,630.35€. Nga shuma e përgjithshme, 6,695,381.83€ janë grantet qeveritare, 2,290,078.00€ janë të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2024, 7,285.16€ janë donacionet dhe 1,099,885.36€ janë mjetet e bartura nga viti 2022 dhe viti 2023.

Buxheti për vitin 2024 është ndarë në pesë grante:

- 1) Granti i përgjithshëm në një shumë prej 3,066,938.83€
- 2) Granti specifik për arsim në një shumë prej 1,733,548.00€
- 3) Granti specifik për shëndetësi primare në një shumë prej 475,813.00€
- 4) Granti specifik për shëndetësi sekondare në një shumë prej 1,090,771.00€
- 5) Granti për shërbimet rezidenciale në një shumë prej 328,311.00€

Nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2024 për paga dhe mëditje është ndarë shuma prej 4,284,719.83€ apo 42,45%, për mallra dhe shërbime është ndarë shuma prej 1,998,803.85€ apo 19,81%, për shërbime komunale është ndarë shuma prej 299,713.13€ apo 2,97%, për subvencione dhe transfere është ndarë shuma prej 591,395.41€ apo 5,86%, për shpenzime kapitale është ndarë shuma prej 2,910,712.97€ apo 28.84%, për donacione shuma prej 7,285.16€ apo 0,07%.

Për gjashtëmujorin e parë është bërë alokimi i mjeteve financiare në një shumë prej 6,659,080.57€ apo 65,98% nga buxheti i përgjithshëm. Alokimi i mjeteve financiare është bërë sipas kategorive ekonomike në shumat e mëposhtme:

- 1) Për paga dhe mëditje në një shumë prej 2,016,031.69€ apo 47.05% nga buxheti
- 2) Për mallra dhe shërbime në një shumë prej 1,895,099.85€ apo 94,81% nga buxheti
- 3) Për shërbime komunale në një shumë prej 289,713.13€ apo 96,66% nga buxheti
- 4) Për subvencione dhe transfere në një shumë prej 584,563.73€ apo 98.84% nga buxheti
- 5) Për shpenzime kapitale në një shumë prej 1,866,387.01€ apo 64,12%
- 6) Për donacione në një shumë prej 7,285.16€ apo 100,00%
- 7) Për rezerva në një shumë prej 0.00 apo 0,00%

Në gjashtëmujorin e parë janë shpenzuar 4,056,825.35€ apo 40,20% nga buxheti i përgjithshëm apo 60,92% nga mjetet e alokuara për gjashtëmujorin e parë.

Sipas kategorive ekonomike janë shpenzuar:

- 1) Për paga dhe mëditje në një shuma prej 2,000,203,64€ apo 46,68% nga buxheti i përgjithshëm apo 99,21% nga mjetet e alokuara
- 2) Për mallra dhe shërbime në një shumë prej 1,029,674.10€ apo 51,51 nga buxheti i përgjithshëm apo 54,33% nga mjetet e alokuara
- 3) Për shërbime komunale në një shumë prej 125,999.81€ apo 42,04% nga buxheti i përgjithshëm apo 43,49% nga mjetet e alokuara
- 4) Për subvencione dhe transfere në një shumë prej 142,500.00€ apo 24,10% nga buxheti i përgjithshëm apo 24,38% nga mjetet e alokuara
- 5) Për shpenzime kapitale në një shumë prej 758,447.80€ apo 26,06% nga buxheti i përgjithshëm apo 40,64% nga mjetet e alokuara
- 6) Për donacione në një shumë prej 0.00€ apo 0,00% nga buxheti i përgjithshëm apo 0,00% nga mjetet e alokuara
- 7) Për rezerva në një shumë prej 0,00 apo 0,00% nga buxheti i përgjithshëm apo 0,00% nga mjetet e alokuara

Në gjashtëmujorin e parë janë realizuar të hyrat vetanake në një shumë prej 1,373,835.31€ apo 59,99% të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2024 dhe të njëjtat janë alokuar në kategoritë ekonomike si në vijim:

- Në mallra dhe shërbime është alokuar shuma prej 67,572.00€
- Në shërbime komunale është alokuar shuma prej 0.00€
- Në subvencione është alokuar shuma prej 58,168.32€
- Në investime kapitale është alokuar shuma prej 1,248,094.99€

Në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2023 janë shpenzuar 267,568.95€ më shumë apo për 7,06%, ndërsa të hyrat vetanake janë për 153,087.40€ apo për 16,97% më të ulta në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2023.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

